

REPUBLIKA E KOSOVES - РЕПУБЛИКА КИ ДОВА РЕ ПЕР - РИПУБЛИК КОВО	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DOP</u>	Nr. Prot. B. Prot. <u>03-3503/10</u> Prot. No
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum <u>25-10-2010</u> Date

Nr.Regj.2-5899/2010

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Pejë, duke vendosur në procedurën kundravajtëse kundër të pandehurit Husnija Bibulica nga fsh.Vitomeriçë KK-Pejë, për vepër kundravajtëse nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në mbështetje ne nenet 30,123,195 dhe 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet më date 09.09.2010 bie këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundravajtëse ndaj të paraqiturit Husnija(Munir) Bibulica nga Fsh.Vitomeriçë reoni nr.II KK-Pejë, dhe atë mbështetur ne nenin 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet – NE MUNGES TË PROVAVE.

A r ë s y e t i m

Agjensioni Kundër Korrupsionit – Prishtinë me kërkesën kundërvajtëse nr. 01/2316/10 të datës 08.06.2010 para kësaj Gjykate ka propozue që të zhvillohet procedura kundravajtëse kundër të paraqiturit të përmendur për vepër kundërvajtëse të cituar ne hyrje të këtij aktvendimi.

Gjatë procedurës paraprake dhe grumbullimit të provave u murrë ne pyetje i paraqituri i cili ne mbrojtjen e vetë deklaroi se qe nga viti 2003 ne fakultetin e shkencave të aplikuara të biznesit ne Pejë ka pune si ligjërues e nga data 01.10.2008 është zgjedhë edhe profesor i rregullt ne këtë fakultet . Ai pastaj deklaroi se aty i ligjëron 4 lëndë dhe se ne vitin 2007 edhe ka doktorue pran Universitetit të Prishtinës. Ne fund i njëjti deklaroi se qe nga data 18.05.2010 nga Senati i Universitetit të Prishtinës dhe Rektori është zgjedhë prodekan i këtij fakulteti . Gjykata bazuar ne shkresat e lëndës shifet se i paraqituri ka patur obligim qe Agjensionit kundër korrupsionit gjerë me 31.03.2010 te ja dorëzon formularin e plotësuar te deklarimit me shkrim të pasurisë ekzistuese të fituar si dhe detyrimeve dhe obligimeve tjera .

Gjykata duke u bazuar ne faktin se ne kohen kurë është ngrit kërkesa kundërvajtëse i paraqituri nuk e ka patur statusin e Zyrtarit të Lartë dhe se këtë status e fiton me vendimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës me nr. reference 1/352 te datës 19.05.2010 e të nënshkruar nga Rektori Mujë Rugova - ndaj të paraqiturit konfrom nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet PEZULLOHET procedura kundërvajtës NE MUNGES TË PROVAVE.

U vendos në Gjykatën Komunale për Kundravajtje në Pejë më date 09.09.2010.

UDHËZIM JURIDIK:Parashtruesi i kërkesës kundër këtij aktvendimi ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditës prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate pa pagesën e taksës.



Gjyqtari,
Bajram REXHAJ